



# A K T   T H E M E L U E S

## I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE "KLIMATEKNIKA TB 2" SH.P.K

Une Petrit Paja, i biri i Avniut, datelindja 20.03.1975, lindur e banues ne Tepelene me adresë Lagja :“Mustafa Matohiti”, madhor, me zotesi te plete juridike e per te vepruar, mbeshitetur ne nenin 251, shkronja “c” te ligjt nr. 7512 date 10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit”, krijoj shoqerine tregtare private me perjegjesi te kufizuar te quajtur **"KLIMATEKNIKA TB 2" SH.P.K** dhe hartoj kete akt themelues si vijon:

### FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqeria private e quajtur **"KLIMATEKNIKA TB 2" SH.P.K.**

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete selite dega.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

### VEND-QENDRIMI I SHOQERISE

Neni 2

Vend-qendrimi i shoqerise tregetare private **"KLIMATEKNIKA TB 2" SH.P.K** do te jete ne Tepelene me adresë Lagja :“Mustafa Matohiti”. Shoqeria do te hape edhe vend-qendrime te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi, ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopmetente edhe jashte vendit.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e tregetimit me pakice dhe shumice, import dhe eksport te : veshmbathje, konfeksione, hodrosanitare, hidraulike, elektrike , detergjente, artikuj tualeti dhe kozmetike, kancelari per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, pajisje elektrike, elektronike e elektoshtepiake, fruta perime, artikujve industriale dhe ushqimore, bujqesore dhe blektorale, bime medicinale e eterovajore, prodhime kozmetike dhe estetike, piye te ndryshme alkoolike e freskuese, automjete te te gjitha llojeve, transport per vete dhe per te tjeret, prodhim dhe tregtim te materialeve duralumin, plastike dhe druri, dyer e dritare shkolllore.etj., pjese kembimi per makina e automjete, goma e bateri, pike servisi,

- Tregtim pajisje dhe makineri mjeksore, laboratorike dhe mjete konsumi ne fushen e mjekesise. # Tregtim te desinfektanteve dhe pesticideve te te gjitha llojeve. # Konstruksion sistem ngrohje e ftoshje, kaldaja me avull e me ngrohje. # Mirembajtje te ambienteve sociale dhe ekonomike, gjelberim te ambienteve te jashtme dhe pastrimine tyre. # Hapje dhe shfrytezim hotelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative.# Ngritje linjash telefonike e telegrafike.
- Shoqeria do te zhvilloje aktivitet edhe ne fushen e ndertimit si dhe tregetimit te mallrave e te materialeve te ndertimit, artikujve dhe makinereve qe lidhen me fushen e ndertimit.

#### Neni 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj, shoqeria do te hape njesi tregetimi, sherbimi dhe perpunimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

#### Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

### KAPITALI I SHOQERISE

#### Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise private "**KLIMATEKNIKA TB 2**" **SH.P.K** do te jete 100.000 leke dhe do te perbehet nga kapitali i ortakut te vetem themelues te shoqerise. Kapitali fillestar mund te shtohet ose pakesohet sipas vendimit te ortakut. Kuota e ortakut ne kapital eshte e gjitha e emeruar dhe e pandashme. Kapitali eshte teresish i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

#### Neni 7

Ortaku duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mos demtoje interesat e personave te tjere.

### DREJTAMI I SHOQERISE

#### Neni 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, ortaku i vetem themelues i shoqerise Petrit Paja.

Neni 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem themelues te shoqerise.

Neni 10

Administratori cakton dhe administratore te tjere te vlerave materjale te shoqerise. Ai ka te drejte te caktoje financiere, likuidator per problemet e shoqerise, si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake. Financieri nxjerr rregullisht treguesit finanziar tre mujore, gjashte mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

Neni 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane, sipas statutit te shoqerise, kontrates te lidhur me palet dhe ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

Neni 12

Shoqeria ka vulen dhe shenjat e veta dalluese.

Neni 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plete te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te ligjt nr. 7368 date 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqerive tregtare".

Neni 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marjes se lejes nga organet kompetente.

Neni 15

Akti i themelimit u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mabetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private "**KLIMATEKNIKA TB 2” SH.P.K**

Akti i themelimit nenshruhet rregullisht nga ortaku themelues.

## **ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**"KLIMATEKNIKA TB 2” SH.P.K**

Petrit Paja



# STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

**"KLIMATEKNIKA TB 2" sh.p.k.**

Une Petrit Paja, i biri i Avniut, datelindja 20.03.1975, lindur e banues ne Tepelene me adrese Lagja :"Mustafa Matohiti", madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, vendosa te miratoje statutin e shoqerise private **"KLIMATEKNIKA TB 2" sh.p.k.** si vijon :

## KREU I PARE

### EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, KAPITALI, OBJEKTI.

Neni 1

Shoqeria emertohet : **"KLIMATEKNIKA TB 2" sh.p.k.**

Neni 2

Selia e shoqerise private **"KLIMATEKNIKA TB 2" sh.p.k.** do te jete ne Tepelene me adrese Lagja :"Mustafa Matohiti".

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i rregjistrimit ne rregjistrin tregtar, prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Neni 4

Kapitali fillestar i shoqerise private **"KLIMATEKNIKA TB 2" sh.p.k.** do te jete 100.000 leke, prone e ortakut te vetem. Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut te vetem themelues te shoqerise.

Neni 5

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e tregetimit me pakice dhe shumice, import dhe eksport te : veshmbathje, konfeksione, hodrosanitare, hidraulike, elektrike , detergjente, artikuj tualeti dhe kozmetike, kancelari per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, pajisje elektrike, elektronike e elektoshtepiake, fruta perime, artikujve industriale dhe ushqimore, buqesore dhe blektorale, bime medicinale e eterovajore, prodhime kozmetike dhe estetike, pije te ndryshme alkoolike e freskuese, automjete te te gjitha llojeve, transport per vete dhe per te tjeret, prodhim dhe tregtim te

materjaleve duralumin, plastike dhe druri, dyer e dritare shkollore etj., pjese kembimi per makina e automjete, goma e bateri, pike servisi,

- Tregtim pajisje dhe makineri mjeksore, laboratorike dhe mjete konsumi ne fushen e mjekesise. # Tregtim te desifikanteve dhe pesticideve te te gjitha llojeve. # Konstruksion sistem ngrohje e ftohje, kaldaja me avull e me ngrohje. # Mirembajte te ambienteve sociale dhe ekonomike, gjelberim te ambienteve te jashtme dhe pastrimine tyre. # Hapje dhe shfrytezim hotelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative.# Ngritje linjash telefonike e telegrafike.
- Shoqeria do te zhvilloje aktivitet edhe ne fushen e ndertimit si dhe tregetimit te mallrave e te materialeve te ndertimit, artikujve dhe makinerive qe lidhen me fushen e ndertimit.

## KREU I DYTE

### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 6

Ortaku i vetem eshte organi me i larte i shoqerise.

Neni 7

Hijne brenda detyrate dhe kompetencave te ortakut te vetem si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe i bilancit te llogarise.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrate e i kompetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i cmimeve per mallrat qe trajton shoqeria, si dhe i tarifave te sherbimeve te saj.
6. Pranimet ne pune dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i vules dhe shenjes dalluese te shoqerise.
8. Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

Neni 8

Administratori jo-ortak pervec detyrate qe i cakton ortaku i vetem ka edhe keto detyra dhe te drejta:

1. Te mireadministroje pasurine e shoqerise.
2. Te beje marrveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise te shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortaku i vetem.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise.
4. Te perqigjet per demet qe i sjell shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen e kryer ne baze te marrveshjes se bere me ortakun e vetem.

6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithcka qe e cmon te dobishme per shoqerine.

### **KREU I TRETE TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE**

Neni 9

Shoqeria ka te drejte:

1. Te importoje dhe te eksportoje mallra ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjilacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punetore te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

Neni 10

Shoqeria ka detyre:

1. Te siguroje kapitalin fillestar ne formen dhe kohen e duhur.
2. Te jape garanci per mallrat qe trajton dhe sherbimet qe kryen.
3. Te siguroje punonjesit e saj.
4. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilidto.
5. Te respektoje standartet shteterore si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

### **KREU I KATERT**

### **MARRDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE**

Neni 11

E gjithe veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

Neni 12

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te cdo viti nxirret bilanci.

Neni 13

Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### Neni 14

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Bankat Brenda teritorit shqiptar. Llogarite mbahen ne leke ose valute dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

#### Neni 15

Nga fitimet e realizuara gjate vitit finanziar, shoqeria, pasi ben zbritjet e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi “Rezerve e domosdoshme”, derisa ky fond te arrije ne masen 10% te kapitalit themeltar.

#### Neni 16

Oratkut te vetem i takon fitimi neto qe realizon shoqeria.

### KREU I PESTE

### DISPOZITA TE VECANTA

#### Neni 17

Shoqeria ka vulen dhe shenjat e veta dalluese.

#### Neni 18

Per plotesimin e nevojave te veta shoqeria mund te punesoje punetore te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.

Me sejcilin punonjes lidhet kontrate individuale e punes, ne baze te legjislacionit qe rregullon marrdheniet e punes. Ne kontrate shenohen detyrat dhe detyrimet reciproke. Per personat qe do te merren ne pune me detyra te vecanta lidhen kontrata individuale.

#### Neni 19

Ne seline shoqerise mbahet nje rregjister i posacem, ne te cilin pasqyrohen vendimet qe merr ortaku i vetem si dhe administratoret jo-ortake.

#### Neni 20

Ne marrdheniet me te tretet shoqeria private “**KLIMATEKNIKA TB 2**” sh.p.k. perfaqesoher nga administratori i saj Petrit Paja, i cili ne rate te vecanta mund te autorizoje persona te tjere per ta perfaqesuar ate.

#### Neni 21

Mosmarrveshjet qe mund ti lindin shoqerise me persona fizike ose juridike, zgjidhen nga gjykatat shqiptare, pervecse ne ato raste kur ne kontrate eshte parashikuar ndryshe.

## KREU I GJASHTE

### SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Neni 22

Shndrrimi i shoqerise "**KLIMATEKNIKA TB 2**" sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet vetem me vendim te ortakut te vetem.

Neni 23

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfardo shkaku, si:

- Humbja e kapitalit te shoqerise.
- Pamundesi veprimi.
- Me vendim te ortakut te vetem.

Ne keto raste, pronari i shoqerise vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke i caktuar edhe detyrat.

Administratori dhe likuidatori jane perjegjes per ruajtejen e pasurise se shoqerise perderisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik apo juridik, duke likujduar ne rrudhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria.

Ne rast se fondet disponibel, rezultojne te pamjftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund ti kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe kuotat qe i takojne atij respektivisht.

### DOSPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 24

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaku i vetem themelues, si edhe ligjeve te vecanta te legjisacionit shqiptar.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne menyren dhe proceduren me te cilien nxirret statuti.

Neni 25

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'i u shperndare organeve kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise private "**KLIMATEKNIKA TB 2**" sh.p.k.

### ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE

"**KLIMATEKNIKA TB 2**" sh.p.k.

Perrit Paja

